

FJALA E DEPUTETES ORJOLA PAMPURI

E ENJTE 10 SHKURT 2022

Të nderuar qytetarë,

E nderuar zonja kryesuese e seancës,

Ajo që të gjithë ne kërkojmë sot është që politika të fitojë besimin te qytetarët dhe besimi te qytetarët nuk fitohet me fjalë boshe, me show, as me propagandë apo me keq akoma me arrogancë; besimi vjen përmes figurave të pastra, të papërlyera nga korrupsioni, me integritet politik, moral apo me integritet profesional. Kjo dhe të gjitha nuk ndodhin pa një drejtësi të pastruar më parë nga korrupsioni. Ky është parimi që mbështesin qytetarët, një politikë e pastër, që u shërben atyre dhe jo xhepave të pushtetarëve. Njerëzit duan që pandëshkueshmërisë së më të fortëve t'i jepet fund! Besoj fort se sot po bëjmë atë që është më e mira për Shqipërinë dhe shqiptarët. Politikanët e korruptuar nuk mund ta kenë vendin këtu; ata që përfitojnë në mënyrë abuzive dhe klienteliste fonde publike nuk mund të mos jenë pjesë e gjykimit të drejtësisë. A ka funksionuar mirë kontrolli i njerëzve të drejtësisë? Patjetër që jo! Janë akoma shumë larg besimit të njerëzve. Ndikimi politik i qeverisë është shumë i fortë. Ajo që mund të them me siguri të plotë është se drejtësia duhet të fillojë të funksionojë pa asnjë dallim.

Këtë e mbështesin fort edhe partnerët tanë strategjikë dhe krahet tyre do të jemi deri në fund, ndryshe ky vend do të kthehet 30 vjet prapa, në atë kohë kur një grusht njerëzish i pinin gjakun popullit, ku ca nga sindroma e Stokholmit, e ca nga pafuqia për të kundërshtuar ishin të detyruar t'u shkonin nga pas. Sot kemi mundësinë e jashtëzakonshme t'u mundësojmë qytetarëve të zgjedhin të lirë e të mbështesin kandidatë, të cilët punojnë për ta, pa iu frikur prapaskenave të korrupsionit dhe abuzimit me detyrën, si dhe, çka është më e rëndësishmja, pa iu nënshtruar bandave dhe shantazhit për tjetërsimin e votës, siç është provuar, atë që nuk do të donim ta dëgjonim, që nga dosja nr. 184, që nga masakra e 25 prillit, kur kemi parë para të dhëna, paratë e tërmetit që u shfrytëzuan për tjetërsimin dhe blerjen e votës, leje ndërtimi, u shfrytëzua e gjithë administrata dhe u vu në përdorim të qeverisë për të blerë dhe tjetërsuar votën.

Këtë shqiptarët nuk duan ta dëgjojnë dhe ta shohin më. Më pas ju vini këtu si triumfatorë dhe thoni "Fituam!". Çfarë fituat? Nuk është fitore ta marrësh, fitore është ta meritosh atë për të cilën punon. 10,5 milionë euro janë paguar për shërbimet e pakryera. Tre koncesione të shëndetësisë janë marrë në analizë nga Kontrolli i Lartë i Shtetit sa u takon pagesave që janë bërë ndaj tyre nga koncesionarët, të cilët nuk kanë dhënë mbarsht shërbimet e tyre. Ky është korrupsion, i cili, falë atij sistemi që ju trumbetoni, ende nuk është gjykuar. Janë miliona euro që janë paguar përgjatë këtyre viteve kundrejt kompanive, të cilat marrin paratë dhe nuk u ofrojnë shërbimet qytetarëve. Këtë e kemi denoncuar gjatë gjithë kësaj periudhe sa u përket inceneratorëve. Prokurorët që dalin të pastër nga vetingu duhet të angazhohen seriozisht me hetimin e këtyre aferave. Qytetarët kërkojnë drejtësi! Drejtësi të plotë vetëm me ish-a nuk ka. Drejtësia duhet të shkojë deri te ministrat dhe Kryeministri, që sot na përбетohen për veting, drejtësi dhe ndershmëri. Këta janë thjesht një fasadë! Këta ministra e pushtetarë pasurohen çdo ditë, ndërsa qytetarët varfërohen e largohen çdo ditë e më shumë nga ky vend. Drejtësia nuk duhet të bjerë në këtë kurth! Nëse ajo nuk vepron me integritet, Shqipëria nuk do të mund të ecë para! Ka edhe një arsye tjetër pse mbështes zgjatjen e afatit për organet e vetingut.

Pavarësisht kritikave të forta që kam për këto organe, të paktën procesi është i mbikëqyrur nga partnerët tanë. Vetingu ndaj gjyqtarëve e prokurorëve është një proces që vijon të përmbushet nën kujdesin e Komisionit Europian dhe Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, të cilët mbikëqyrin procesin. Normalisht, çdo nismë, e cila synon të përmirësojë e të pastrojë çdo sistem nga korrupsioni, do të mbështetet nga Partia Demokratike. Shqiptarët duan një politikë të pastër, të shkëputur nga korrupsioni. Të korruptuarit duhet të qëndrojnë larg politikës sot, që qytetarët nesër të afrohen dhe të votojnë me bindje kandidatët e secilës forcë politike, nëse ata do të jenë të pastër dhe të pakorruptuar.

Sot kjo qeveri ka dy ish-ministra në burg për korrupsion dhe trafik droge. Të gjithë pyesin se si mund të qëndrojnë këtu, të flasin, të premtojnë, të trumbetojnë fitore, ndërkohë që dy ish-ministrat e tyre, që me bekimin e tyre kanë bërë atë çka kanë bërë, janë sot në burg. Besimi te politikanët është prioritet dhe që kjo gjë të arrihet, duhet vetingu në politikë. Largimi i të korruptuarve është detyrim i të gjithëve ne, që duam të lëmë një emër të mirë në politikën shqiptare. Sot ne do të votojmë edhe një projekt tjetër të rëndësishëm politik. Partia Demokratike ia doli që të sjellë në këtë Kuvend zërin dhe interesin e qytetarëve për reformën territoriale. Reforma administrative-territoriale, ashtu sikurse e kemi dëgjuar të kërkohet shpesh përgjatë takimeve që kemi në terren, është detyrim i secilit nga ne për të rinisur punën. E përmendën edhe kolegët më parë që reforma territoriale duhet bërë, sepse u shërben qytetarëve, ajo bashkë me nisjen e reformës zgjedhore janë dy nga arritjet, për të cilat Partia Demokratike do të jetë krenare, qytetarët, gjithashtu, do të jenë krenarë bashkë me ne! Sigurisht, kur këto dy reforma të finalizohen, do ta bëjnë Shqipërinë më europiane, një vend më të mirë për fëmijët tanë, që të prodhojë një qeverisje të ndershme dhe në shërbim të shqiptarëve. Faleminderit!